

## SPECIFIKIME TEKNIKE

### I. Transporti dhe largimi i mbetjeve urbane

#### 1- Pershkrimi I zones

Shtrirja	793.36 km <sup>2</sup>
Kufiri	31 892
Siperfaqe	
Popullsia	31 892 banore
Dendesia	

Bashkia Librazhd eshte njesi administrative vendore dhe ben pjesa ne prefekturen e Qarkut Elbasan.

Qyteti ka nje popullsi prej 11500 banore me rreth 2810 familje. Siperfaqa administrative e bashkise eshte 170 ha, kufizohet nga te gjitha anet nga territori I njesise administrative Qender. Qyteti shtrihet per gjate lumbit Shkumbin ne nje gjatesi rreth 3 km ku mbizoteron relieve kodrinore dhe ultesira per gjate shtratit te lumbit Shkumbin.

#### 2- Volumi I punimeve

Mbetjet urbane ne kete zone do te grumbullohen ne kontenier dhe transportimi i tyre do te behet me mjete teknologjike .

Per transportin e mbetjeve urbane me mjete teknologjike subjekti fitues ne tender do te vendose 179 kontenier sipas percaktiveve te autoritetit kontraktor te cilat jane ne posedim te vete operatorit te sherbimit. Autoriteti kontraktor ka parashikuar paraprakisht vendosjen e 179 konteniereve me volum 1.1 m<sup>3</sup> ne te gjitha pikat e grumbullimit te pasqyruara ne harten e zones dhe ne listen perkatese te specifikuara , njesia, emertimi i rruges. Numri i konteniereve eshte percaktuar nga volumi mbetjeve qe prodhohen e depozitohen ne to, te vleresuara nga specialistet 7.8 ton ne dite si dhe nga eksperiencia shume vjecare e kryerjes se ketij sherbimi ne plotesim te kerkesave te komunitetit. Operatori duhet te kryeje sherbimin e zbrazjes gjithsej te 179 konteniereve ne makinat teknologjike , transportimin dhe shkarkimin e mbeturinave e fushen ekzistuese te plehrave e cila ndodhet brenda vijes se verdhe te qytetit. Operatori i sherbimit vendos dhe garanton numrin e konteniereve ne vazhdimesi te kontrates.

#### 3- Largimi i mbetjeve urbane konsiston ne:

- Zbrazjen e konteniereve ne makinat teknologjike, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave te hedhura per rreth konteniereve, fshirjen me krah te siperfaqes me

rreze 3 m te V.G.M dhe rivendosjen e konteniereve ne vendin e caktuar ne menyre te rregullt dhe estetike.

Me pas makina teknologjike kryen transportin e mbeturinave per ne fushen e depozitimit te tyre.

- Kontenieret do te perpunohen me nje frekuence cdo dite per bashkine dhe nje here ne tre dite per njesite administrative ne varesi te saj.
- Ne perfundim te ketij procesi perfshihet edhe dezinfektimi i konteniereve dhe i zones per rreth me gelqere me 5% permajtje klori.

#### **4- Mjetet qe do te perdoren**

Operatori i sherbimit per realizimin e sasise se mbetjeve urbane qe do te transportohen nga kontenieret duhet te vere ne sherbim mjetet e nevojshme dhe te pershtatshme si me poshte:

- Makina teknologjike transportuese me ngarkim fundor ose anesor me kapacitet mbajtes jo me pak se 10 ton, me raport kompaktimi 1:4 deri 1:6 jo me pak se dy cope.

Operatori i sherbimit mund te ofroje numer dhe kapacitete te ndryshme mjetesh teknologjike transportuese dhe mjete transperti veteshkarkuese ,por pa zvogeluar numrin e mjeteve teknologjike cope 1 me kapacitet transportues jo me pak se 10 ton.Operatori per te mbuluar gadishmerine tekniqe te mjeteve teknologjike duhet te disponoje edhe nje mjet reserve me tonazh mbi 8 ton.

- Mjetet e largimit te mbeturinave duhet te lahlen dhe dezinfektohen cdo dite pas perfundimit te punes.
- Te gjithe kontenieret e perdonura per kryerjen e ketij sherbimi duhet te mbahen paster dhe ne gjendje te mire tekniqe, ne rast deformimesh demtime rrotash apo dejgie te cilat cojne ne mosfunkcionimin e tyre per cdo shkak duhet te zevendesohen nga operatori.
- Ne te gjitha mjetet e perdonura per qellim transportin e mbetjeve urbane duhet te shkruhet “Mbani paster qytetin tuaj”
- Kontenieret te kene numrin perkates dhe mbishkrimin “Bashkia Librazhd”

#### **5- Plani i vendosjes se konteniereve dhe grafikeve te punimeve.**

- Ne fillim te kesaj kontrate autoriteti kontraktor ka percaktuar pikat e grumbullimit te mbetjeve urbane dhe numrin e konteniereve per cdo pike ne te gjithe zonen e kryerjes se sherbimit. Operatori vendos kontinier te pershtatshem , me kapacitet jo me te vogel se 1.1 m3, para fillimit te sherbimit.

- Operatori eshte i detyruar te zbatoje planin fillestar te pikave me kontenieret perkates, si dhe ndryshimin e tyre per gjate zbatimit te kesaj kontrate. Ky plan mund te ndryshoje gjate zbatimit te kontrates nga operatori i sherbimit ose autoriteti kontraktues sipas nevojave per permiresimin e sherbimit dhe mireorganizimit te tij ose si rezultat i ndryshimeve qe mund te ndodhin ne infrastrukturre gjithmone ne baze te kerkeses se njeres pale dhe behet e zbatueshme pas miratimit te autoritetit kontraktor.
- Grafiku vjetor per realizimin e sherbimit per gjate zbatimit te kontrates nga operatori dhe miratohet cdo vit nga autoriteti kontraktor. Keta grafike mund te pesojne ndryshime sa here lind e nevojshme dhe brenda nje viti. Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohet :
  - a. Orari i fillimit te sherbimit per cdo mjet
  - b. Lloji, targa dhe itinerari i makinave teknologjike dhe mjeteve te tjera transportuese veteshkarkuese qe do te kryejne sherbimin.
  - c. Numri i punetoreve qe do te mbeshtesin cdo operacion punimesh.

*Operatori i sherbimit nuk mund te punoje e te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.*

- Grafiket e largimit te mbeturinave qe do te paraqiten per miratim duhet te paraqiten ne menyre te tille qe te gjitha punimet te kryhen gjate oreve te nates, me qellim qe ne oren 08:00 zona e kontrates te jete plotesisht e paster. Pastrimi i rrugeve kryesore qe kane trafik mjetesh te parashikohen te kryhen gjate oreve te nates.
- Autoriteti kontraktues ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe pas perfundimit te sherbimit VGM, te shohe respektimin e kerkesave, rregullave dhe cilesine e kerkuar nga kjo kontrate per te vendosur penalite ose ndalesa ne rastet e mospermushjes se tyre.

## **6- Rregulla per tu zbatuar**

- Operatori duhet te mbaje paster VGM ne perputhje me rregulloren e miratuar me VKB nr 29 date 29.04.2008 " Per administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e qytetit"
- Operatori i sherbimit ka per detyre te kryeje grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane qe depozitohen ne ambjentet publike brenda zones se kontrates edhe ne rastet kur mbetjet hidhen ne menyre te perseritur. Ne keto raste operatori i sherbimit ka te drejte te kerkoje miratimin e vendosjes se konteniereve dhe perfshirjen e tyre ne grafikun e punimeve.

- Operatori duhet te informoje me shkrim autoritetin kontraktues ne menyre periodike per te gjitha kontratat private te pastrimit qe do te kete me te tretet, te reklamoje numrin e mjeteve dhe punetoreve shtese per keto sherbime ,per te garantuar cilesine e kerkuar te sherbimit ne kontraten me autoritetin kontraktor.
- Operatori i sherbimit duhet te kete ne eficence nje “zyre kontaktimi” per marrjen e ankesave nga qytetaret per te gjitha proceset e sherbimit te pastrimit te parashikuara ne kontrate. Kjo zyre duhet te jete e hapur ne te gjithe ditet e javes nga ora 7:00 deri me 20:00. Perfaqesuesi i operatorit duhet te jete prezent gjate gjithe kohes se parashikuar per te marre verejtjet e qytetareve dhe autoritetit kontraktues qe mund te kene per te gjitha proceset e sherbimit te parashikuara ne kontrate dhe per tu dhene zgjidhje problemeve te prezantuara brenda 5 oreve nga marrja e njoftimit.
- Operatori i sherbimit detyrimisht duhet te kete cdo dite (ose naten) ne pune minimalist numrin e kerkuar te mjeteve.
- Ne asje rast nuk duhet te kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenieret ne akset kryesore te rrugeve para se te jete kryer fshirja dhe pastrimi i tyre.
- Perdorimi i uniformave te punetoreve qe kryejne sherbimin e pastrimit eshte rigorozisht i detyrueshem.

## II. Fshirja e rrugeve dhe trotuareve me krahe

- **Volumet e punimeve**

Autoriteti kontraktues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rruget, trotuaret dhe siperfaqet e tyre per te gjithe zonen e kontraktuar. Operatori i sherbimit do te fshije me krahe dhe do te kryeje te gjitha sherbimet e tjera mbeshtetese parashikuar me metodologji per te gjitha rruget dhe trotuaret e percaktuara, ne zonen qe do te kontraktohet, volumet e te cilave jane te parashikuara sipas frekuencave dhe siperfaqeve perkatese te rrugeve te dhena ne listen bashkengjitur.

- **Fshirja e rrugeve dhe trotuareve me krahe**

1. Fshirje te rrugeve me puntore, konsiston ne pastrimin (fshirjen me fshese)e shesheve ,rrugeve e trotuareve nga pluhurat e materialeve te tjera te ngurta, organike dhe jo organike.
2. Volumet e punes jane nxerre ne baze te siperfaqeve te shesheve , rrugeve,trotuareve dhe frekuencave te sherbimit, te cilat jane te pasqyruara ne listat emertuese perkatese.
3. Punetoret (fshesaret) qe do te kryejne kete proces sherbimi pastrimi duhet te jene te mireinformuar per respektimin e ketyre kerkesave ne realizimin e volumit

te punes se planifikuar.

4. Operatori i sherbimit duhet te zbraze, pastroje vendin per rreth dhe te mbaje paster cdo dite te gjithe koshat rrugore brenda zones se kontraktuar. Sherbimi i zbrajzes dhe pastrimit te ambientit rreth tyre behet gjate nates.

- **Plani i punes dhe grafiket e punimeve**

1. Fshirja e rrugeve do te behet gjate nates nga ora 23.00-05.00
2. Grafiket e punimeve per realizimin e sherbimit te pastrimit te zones, perqatiten nga sipermarresi dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti Kontraktues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime ne oren e operimit dhe perfundimit te sherbimit, sa here lind e nevojshme dhe brenda nje viti, vetem per shkak te pamundesise se kryerjes ne rruge te vecanta dhe dite te vecante, gjithmone pasi te jene miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktues keto ndryshime.
3. Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohen sakte: oraret e operimit ne secilen rruge dhe trotuar, si dhe numri i punetoreve qe do te punojne ne cdo operacion punimesh.
4. Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit. Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
5. Autoriteti kontraktues ka te drejte te inspekoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e standarteve te kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate si dhe per te vendosur penalitetet, gjoba dhe ndalesa per mospermbushjen e tyre.

- **Rregulla per tu zbatuar**

1. Operatori i sherbimit duhet te mbaje paster cdo siperfaqe rruge dhe trotuari ne perputhje me VKB nr. \_\_\_\_ date \_\_\_\_/\_\_\_\_/2020 "Per administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e qytetit" dhe ne kushtet e kesaj kontrate.
2. Per asnjë rast nuk do te lejohen rruge te papastruara apo mbeturina te palarguara ne to. Ne te gjitha rastet kur evidentohen blllokime apo pengesa nga faktore te jashtem te cilat nuk mund te pastrohen me operacionet e parashikuara ne metodologji, operatori i sherbimit duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per pastrimin e tyre jo me vone se tre ore nga orari i perfundimit te sherbimit i perçaktuar ne grafik. Ne rast te kundert perqejjesia eshte e operatorit te sherbimit dhe do te penalizohet sipas parashikimit ne kontrate.

3. Operatori i sherbimit duhet te kete ne eficense nje "Zyre te Kontaktimit" per marrjen e masave e cila duhet te jete e hapur ne te gjithe ditet e javes nga ora 7.00-20.00. Perfaqesues te operatorit te sherbimit duhet te jene prezent gjate gjithe kohes se parashikuar per te marre verejtjet e qytetareve dhe Autoritetit Kontraktues dhe per tu dhene zgjidhje problemeve te prezantuara brenda 5 oresh nga marrja e njoftimit.
4. Operatori i sherbimit duhet te kete cdo dite ne pune minimalisht numrin e punetoreve dhe pajisjeve sipas numrit te deklaruar ne oferten e tenederit per te garantuar kryerjen me cilesi dhe ne kohe te sherbimit.
5. Per raste te vecanta operatori i sherbimit eshte i detyruar te fshije rruget me shume se nje here pa shpenzime.
6. Gjate procesit te fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave ne pusetat e elektrikut, telefonise, te ujesjellesit, ujrate te zeza, hidranteve , ne zgarat e pusetave te ujrate atmosferike, ne shtreterit e perrenjve dhe zonat e gjelbra. Ne rast te konstatimit te kesaj dukurie operatori i sherbimit detyrohet t'i pastroje menjehere. Ne rast te perseritjes apo mospastrim te tyre brenda 5 oresh nga marrja e njoftimit, pervec pergjegjesise se mbartjes se shpenzimeve perballat me penalite sipas kesaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve ne fuqi per ndotjen e shkaktuar.
7. Ndalohet ne menyre kategorike ngritja e pluhurit gjate proceseve te fshirjes per shkak te ndotjes qe shkaktojne.
8. Perdorimi i uniformave per punetoret eshte rigorozisht i detyrueshem dhe do te ndermerren gjoba per mosplotesim te tyre.
9. Gjithashtu punetoret e pastrimit duhet te perfitorje trajnim special ne perputhje me normat higjenike ne fuqi per shkak te llojit te punes qe kryejne.
10. Operatori qe do te kryej kete sherbim te sensibilizoje komunitetin , nepermjet mjeteve te edukimit te publik:
  - a. Per te mbajtur nje qytet te paster brenda standarteve bashkekohore.
  - b. Te mos hidhen mbetje te ndryshme organike apo inerte ne ambjentet publike dhe ne shtratet e perrenjve .
  - c. Te mos parkohen automjete perpara vendeve te konteniereve te mbetjeve urbane.

- **Mjetet dhe pajisjet**

Operatori i sherbimit duhet te vere ne dispozicion per plotesimin e detyrave kontraktuale te fshirjes me krahe te rrugeve dhe trotuareve si dhe te gjitha Sherbimeve Plotesuese te percaktuara me lart, keto mjete dhe pajisje:

- a.Fshesa (duhet te jete e bute, e perthyeshme dhe elastike, prej materiali plastik, shqop ose gjineshter)
- b.Lopata (te pershatshme per kete process pune)

*Pajisjet dhe veglat e punes te mbahen ne gjendje te paster dhe te mire.Punetoret e fshirjes duhet te jene te pajisur me fshese,kruajtese, lopata, kazane dore levizese dhe karroca dore.*

### **III. MIREMBAJTJA E PJESSHME E RRUGEVE**

- **Mirembajtja e pjeshme e shesheve, rrugeve dhe e trotuareve , konsiston ne:**

*Mirembajtjen dhe pastrimin me punetore gjate dites te trotuareve shesheve dhe rrugeve kryesore, duke mbledhur dhe larguar te gjitha mbetjet e vogla dhe te medha te hedhura ne siperfaqet e tyre si rezultat i aktivitetit tregtar dhe te kembesoreve , mbajtjen paster gjate dites te koshave rrugore dhe vendit rreth tyre, etj.*

- **Volumi i punimeve**

*Operatori i sherbimit do te kryeje mirembajtje te pjesshme te shesheve trotuareve dhe rrugeve kryesore te parashikuara dhe te pasqyrura ne listen bashkengjitur. Mirembajtja e pjesshme do te behet gjate oreve te dites nga ora 10.00 deri 18.00*

*Autoriteti kontraktues ka parashikuar paraprakisht te gjitha rruget qe do u sherbehet me mirembajtje te pjesshme dhe siperfaqet e tyre per te gjithe zonen e kontraktuar.*

- **Plani i punes dhe grafiket e punimeve**

1. *Sherbimi i mirembajtjes se pjesshme do te kryhet sipas grafikeve te miratuar nga Autoriteti kontraktues, me qellim qe gjate gjithe dites trotuaret, sheshet e rruget e percaktuara per sherbim te jene krejtesisht te pastrer ose duke u pastruar. Sherbimi i mirembajtjes se plote kryhet ne rruget dyesore e tretesore qe nuk jane perfshire ne procesin e fshirjes me krah dhe do te kryhet sipas grafikeve te hartuara nga operatori dhe te miratuara nga autoriteti kontraktues me qellim te mbajtjes paster te territorit urban.*
2. *Grafiket e punimeve per realizimin e ketyre sherbimeve preqatiten nga sipermarresi dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontraktues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime ne oren e operimit dhe perfundimit te sherbimit sa here lind e nevojshme dhe brenda nje viti, dhe gjithmone pasi te jene miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktues keto ndryshime.*
3. *Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohen sakte: 1. Oraret e operimit ne secilen rruge dhe trotuar. 2. Numrin e punetoreve qe do te punojne ne cdo segment rrugor.*

4. Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit. Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
5. Autoriteti kontraktues ka te drejte te inspekoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e standarteve te kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate si dhe per te vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa per mosperputhjen e tyre.

- **Rregulla per tu zbatuar**

1. Operatori i sherbimit duhet te mbaje paster te gjithe siperfaqen e planifikuar ne perputhje me VKB nr.\_\_\_\_ date \_\_\_\_/\_\_\_\_/2020 " Per administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e qytetit" dhe ne kushtet e kesaj kontrate.
2. Per asnjë rast nuk do te lejohen trotuare, rruge, sheshe te papastruara apo mbeturina te palarguara ne to. Ne te gjitha rastet kur evidentohen blllokime apo pengesa nga faktore te jashtem te cilat nuk mund te pastrohen me operacionet e parashikuara ne metodologji, operatori i sherbimit duhet te njoftoje menjehere dhe te marre masa per pastrimin e tyre jo me vone se 3 ore nga orari i perfundimit te sherbimit i percaktuar ne grafik. Ne rast te kundert perqejjesia eshte e operatorit te sherbimit dhe do te penalizohet sipas parashikimit ne nenin "Sanksione".
3. Operatori i sherbimit duhet te kete cdo dite ne pune minimalisht numrin e punetoreve sipas numrit te deklaruar ne oferten e tenederit per te garantuar kryerjen me cilesi dhe ne kohe te sherbimit.
4. Gjate procesit te mirembajtjes se pjesshme e te plete gjate dites apo gjate nates te parashikuara ne kontrate, i trotuareve, rrugeve e i shesheve ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave ne pusetat e elektrikut, telefonise, te ujesjellesit, ujrate te zeza, hidranteve , ne zgarat e pusetave te ujrate atmosferike, ne shtreterit e perrenjve dhe zonat e gjelbra. Ne rast te konstatimit te kesaj dukurie operatori i sherbimit detyrohet t'i pastroje menjehere. Ne rast te perseritjes apo mospastrim te tyre brenda 5 oresh nga marrja e njoftimit, pervec perqejjesise se mbartjes se shpenzimeve perballat me penalitete sipas kesaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve ne fuqi per ndotjen e shkaktuar.
5. Perdorimi i uniformave per punetoret eshte rigorozisht i detyrueshem dhe do te ndermerren gjoba per mosplotesim te tyre.
6. Gjithashtu punetoret e pastrimit duhet te perfitojne trajnim special ne perputhje me normat higjenike ne fuqi per shkak te llojit te punes qe kryejne.

#### **IV.Freskimi (Lagia e rrugeve)**

- **Freskimi (lagia) e rrugeve konsiston ne:**

1. Freskimin (lagien ) e gjithe gjeresise dhe gjatesise se rruges me uje te paster dhe me presion me sasi 1 liter per m2.
2. Periudha e kryerjes se ketij sherbimi do jete korrik – gusht.

- **Plani i Punes dhe Grafiket e punimeve**

1. Orari i kryerjes se ketij sherbimi do te jete 04.00 -09.00
2. Cdo rruga kryesore dhe dytesore, percaktuar sipas listes se rrugeve per sherbimin e freskimit, do te perfitoje sherbimin nje here ne dite sipas grafikeve te hartuar per kete qellim.
3. Grafiket e punimeve per realizimin e sherbimit te freskimit te rrugeve perqatiten nga sipermarresi dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontraktues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime ne oren e operimit dhe perfundimit te sherbimit, sa here lind e nevojshme edhe brenda nje viti, vetem pasi te jene miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktues keto ndryshime.
4. Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohen sakte:
  - a. Oraret e operimit ne secilen rruga
  - b. Llojin dhe intenerarin e makinave teknologjike qe do te kryejne sherbimi.
  - c. Numrin e punetoreve qe do te punojne ne cdo operacion punimesh.
5. Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori i sherbimit. Operatori i sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit. Operatori i Sherbimit do te kryeje freskimin me uje te rrugeve te percaktuara ne listen emertuese me volume perkatese, bashkengjitur kesaj kontrate.
6. Autoriteti kontraktues ka te drejte te inspekoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e standardeve te kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa per mospermbushjen e tyre.

- **Rregulla per tu zbatuar**

- a) Autoriteti kontraktues do te inspekoje gjate ose pas perfundimit te sherbimit , per te siguruar rigorozisht efektivitetin e ketij sherbimi dhe cilesine e kerkuar.
- b) Ky proces sherbimi do te kryhet vetem pasi eshte kryer procesi i fshirjes me krah
- c) Freskimi te kryhet me uje te paster , me normative 1 liter /m2
- d) Shpejtësia e levizjes se mjetit gjate kryerjes se sherbimit duhet te jete ne varesi te kapacitetit te pompes dhe normes se freskimit me uje per cdo meter katror.

- e) Ne te gjitha rastet kur nuk eshte e nevojshme kryerja e sherbimit te freskimit me uje te rrugeve per shkak te kushteve atmosferike si shi apo ngrice, operatori i sherbimit nuk do te kryeje kete sherbim dhe si rrjedhim nuk do te paguhet.
- f) Perfaqesuesit e Autoritetit kontraktues do te shenojne ne procesverbalet ditore dhe mujore te gjitha ditet dhe volumet perkatese , qe per shkak te reshjeve nuk eshte kryer sherbimi I freskimit me uje te rrugeve dhe mund ti kerkonte operatorit te sherbimit plotesimin e ketij detyrimi gjate stines se veres apo diteve te tjera te viti, kur eshte me e nevojshme, pas nje kerkese zyrtare te Autoritetit Kontraktues dhe pagesa do te behet atehere kur te kryhet.
- g) Do te konsiderohet e pavlefshme kryerja e ketij sherbimi ne kushtet e reshjeve atmosferike te peshkruara me siper. Do te beje perjashtim vetem ne rastet kur kryerja e ketij sherbimi kerkohet nga Autoriteti kontraktues per shkaqe te ndryshme.
- h) Autoriteti kontraktues do te stimuloje operatorin e sherbimit te perdore burime te tjera per te sigurimin e ujit per larjen e rrugeve si puse etj.
- i) Operatori i sherbimit detyrimisht duhet te kete cdo dite (ose nate) ne pune , minimalisht numrin e kerkuar te makinerive dhe pajisjeve per freskimin e rrugeve

- **Mjetet dhe pajisje per freskimin (larjen) e rrugeve.**

*Operatori I sherbimit duhet te vere ne dispozicion dhe te perdore per plotesimin e detyrave kontraktuale te sherbimit te larjes se rrugeve keto mjete:*

1. Makina per larjen e rrugeve, (autobote) te pajisura me pompe dhe me nje tub anesor per nxjerrjen e ujit me presion, me kapacitet mbajtes jo me pak se 8000 litra uje, jo me pak se 1 cope. Makinat per larjen e rrugeve duhet te jene te rregjistruala nga Autoriteti kontraktues , te mbahen ne gjendje te paster dhe te mire, si dhe te jene te lyera me te njeften ngjyre.
2. Nje sasi e konsiderueshme e pjeseve te nderrimit duhet te mbahen gati per te siguruar plotesimin ne kohe dhe te vazhdueshme te kontrates.

#### **V.Larja e rrugeve me makine teknologjike :**

- **Volumet e punimeve**

a.Krahas freskimit te rrugeve , Autoriteti kontraktues ka parashikuar paraprakisht sheshet,rruget dhe siperfaqet e tyre qe do te lahen me uje me presion per te gjithe zonen e kontraktuar me frekuence nje here ne muaj.

b.Autoriteti kontraktues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rruget , trotuaret dhe siperfaqet e tyre , ne te cilat do te kryhet sherbimi I larjes speciale periodike te rrugeve per te gjithe zonen e kontraktuar sipas listes se rrugeve dhe volumeve te tyre per sherbimin e larjes speciale. Operatori I sherbimit do te kryeje larjen speciale periodike me presion te rrugeve ne volum e frekuence te caktuar ne anekskontrate.

- **Specifikime teknike dhe metodologjia**

a. Sherbimi i larjes me presion, me makineri teknologjike konsiston ne:

1. Larjen me presion me makineri teknologjike larese, si sherbim nje here ne muaj, I te gjithe rrugeve kryesore, shesheve te parashikuara , ne menyre qe makinat larese te mbulojne me sherbim te gjitha siperfaqet e plot ate tyre te parashikuar.

2. Gjate sherbimit te larjes shpejtesia e operimit te makinave larese gjate procesit te larjes (zbrazjes se ujit) duhet te varioje nga 8-10 km/ore.

• **Plani i punes dhe grafiku i punimeve**

- a. Larja e rrugeve, si sherbim nje here ne muaj, do te behet cdo dite, gjithmone pas sherbimit te pastrimit (fshirjes se rrugeve), nga ora 2-00 deri 7-00.
- b. Grafiket e punimeve per realizimin e sherbimeve te larjes se rrugeve, perqatiten nga Operatori I Sherbimit dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontraktues. Keta grafike mund te pesojne ndryshime ne oren e operimit dhe perfundimit te sherbimit, sa here lind e nevojshme ne oren e operimit dhe perfundimit te sherbimit, sa here lind e nevojshme eshe Brenda nje viti, vetem per shkak te pamundesise se kryerjes dhe gjithmone pasi te jene miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktues keto ndryshime.
- c. Ne grafikun e punimeve duhet te percaktohen sakte: 1.Oraret e operimit ne secilen rruge dhe trotuar. 2.Llojin dhe intinerarin e makinave teknologjike qe do te kryeje sherbimin. 3.Numrin e punetoreve qe do te punojne ne cdo operacion punimesh.
- d. Grafiket e punimeve duhet te zbatojen rigorozisht nga operatori I sherbimit. Operatori I sherbimit nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratimin paraprak te grafikut te punimeve apo kur grafikut I ka kaluar afati I zbatimit.
- e. Autoriteti kontraktues ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e standardeve te kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa per mospermbushjen e tyre.

• **Rregulla per tu zbatuar**

- a. Autoriteti kontraktues ka te drejte te kontrolloje gjate kryerjes se sherbimit dhe pas perfundimit te tij, respektimin e standardeve ne presionin e ujit per larje si dhe duke kontrolluar here pas here sasine e ujit te perdonur per larjen e siperfaqes se parashikuari. Ne rastet kur evidentohet presion I pamjaftueshem ne larje apo sasi e vogel e ujit te perdonur, sherbimi I larjes do te konsiderohet e pavlefshem.
- b. Operatori I sherbimit duhet te kryeje sherbimin e larjes me presion te rrugeve duke respektuar standartin e harxhimit te 5 liter uje per 1 m<sup>2</sup>.
- c. Larja duhet te behet me uje me ngarkese bakteriale jo me shume se 200 E koli per 100 ml uje.
- d. Ne te gjitha rastet kur nuk eshte e nevojshme kryerja e sherbimit te larjes me makineri per shkak te kushteve atmosferike si shi apongrice, operatori I sherbimit nuk do te kryeje kete sherbim dhe si rrjedhim nuk do te paguhet.

- e. Perfaqesuesit e Autoritetit kontraktues do te shenojne ne procesverbalet ditore dhe situacionet mujore, te gjitha ditet dhe volumet perkatese, qe per shkak te reshjeve nuk eshte kryer sherbimi i larjes me presion dhe mund ti kerkoje Operatorit te Sherbimit kryerjen e ketij sherbimi ne ditet e tjera te viti ose gjate stines se veres kur te jetë e nevojshme, ne perputhje me cmimet njesi te perventivit te punimeve dhe siperfaqeve te rrugeve sipas listes se rrugeve bashkengjitur kontrates, nje kerkese zyrtare te Autoritetit kontraktues, si dhe pagesa do te behet atehere kur te kryhet.
- f. Do te konsiderohet e pavlefshme larja e rrugeve ne kushtet e reshjeve atmosferike te peshkruara me siper. Do te beje perjashtim vetem ne rastet kur kryerja e ketij sherbimi kerkohet nga Autoriteti kontraktues per shkaqe te ndryshme.
- g. Autoriteti kontraktues do te nxise operatorin e sherbimit te perdore burime te tjera per sigurimin e ujit per larjen e rrugeve, sip use etj.
- h. Listat perkatese te rrugeve qe do te lahen i bashkengjiten kesaj kontrate
- i. Te gjitha shpenzimet per ujin, qe do te perdoren per larje do te mbarten nga operatori i sherbimit.

- **Mjetet dhe pajisjet per larjen e rrugeve**

- a. Operatori i sherbimit duhet te siguroje per realizimin e larjes me presion te rrugeve sipas percaktiveve te kontrates, te gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet perkatese
- b. Operatori i sherbimit duhet te vere ne dispozicion dhe te perdore per plotesimin e detyrave kontraktuale te larjes se rrugeve keto mjete:
  - 1. Makina per larjen e rrugeve (autobote) te pajisura me pompe per larjen e rrugeve me presion, me dy ose me shume pjata larese ne pjesen e perparme, me kapacitet mbajtes jo me pak se 10000 litra uje, jo me pak se (1) nje cope.
  - c. Automjetet te cilat duhet te perdoren per larjen e rrugeve duhet te inspektohen cdo 6 muaj nga Autoriteti kontraktues. Cdo makineri per larjen e rrugeve duhet te pastrohet dhe lahet, ne fillim ose ne fund te itinerarit ditor.
  - d. Te gjitha makinat per larjen e rrugeve duhet te mbahen ne gjendje te paster dhe te mire, si dhe te jene te lyera me te njejtën ngjyre.
  - e. Nje sasi e konsiderueshme e pjeseve te nderrimit duhet te mbahen gati per te siguruar plotesimin ne kohe dhe te vazhdueshem te kontrates.
  - f. Nje liste e makinave larese do ti paraqitet Autoritetit Kontraktues para fillimit te veprimtarise se larjes.

#### **V.Larja dhe dezinfektimi i konteniereve**

- **Volumi i punimeve**

**Operatori i sherbimit do te laje dhe dizinfektoje \_\_\_\_ konteniere me volume 1.1 m<sup>3</sup> ne muaj ose mesatarisht \_\_\_\_ ne dite, sipas grafikeve te miratuar nga Autoriteti kontraktues.**

- **Metodologja**

1. Operatori i sherbimit do te grumbulloje dhe transportoje kontenieret cdo nate ne autoparkun e tij dhe te kryeje larjen e plete dhe dizinfektimin e tyre atje. Kontenieret do te largohen detyrimisht pas zbrazjes se plete te tyre.
2. Per te mundesuar kryerjen e ketij sherbimi operatori I sherbimit do te kete ne dispozicion nje numer te nevojshem kontenieresh reserve per te zevendesuar cdo nate kontenieret e larguara per tu lare.
3. Kontenieret per mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brenda dhe jashte me uje me presion, duke perdorur furce dhe solucion lares.
4. Me sherbim dizifikimi kuptojme realizimin e sherbimit te dizifikimit dhe deratizimit te te gjithe siperfaqes se jashtme dhe te brendshme te kontenierit.

- **Grafiket e punimeve**

1. Grafiket e punimeve per transportin, larjen dhe dizinfektimin e konteniereve , perqatiten nga operatori I sherbimit dhe miratohen cdo vit nga Autoriteti kontraktues.
2. Grafiket e punimeve duhet te zbatohen rigorozisht nga operatori I sherbimit , I cili nuk mund te punoje dhe te paguhet pa miratim paraprak te grafikut.
3. Autoriteti kontraktor ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe ne perfundim vendet e grumbullimit te mbeturinave per te pare kryerjen e sherbimeve te siperpermendura, respektimin e standarteve te kerkuara, rregullave dhe cilesise se kerkuar nga kjo kontrate dhe per te vednosur penalite, gjoba dhe ndalesa per mosperm bushjen e tyre.

- **Rregulla per t'u zbatuar**

1. Ky sherbim do te kryhet detyrimisht pasi te jete bere zbrazja dhe pastrimi I konteniereve te mbledhjes se mbeturinave urbane, tregjeve etj.
2. Te gjitha lendet dizinfektuese dhe aromatike qe perzihen me ujin per larjen dhe dizinfektimin e konteniereve, pra perberja dhe leja e perdorimit te tyre miratohet me pare nga organet shteterore dhe shendetesore dhe me pas nga Autoriteti kontraktues. Mosmiratimi I lendeve kimike te perdorura para perdorimit te tyre do te beje